



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni IV

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 11.**

Prishtinë, më 26.07.2011 në ora 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Myzejene Selmani, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Agim Kuleta, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Mufera Sinik dhe Etem Arifi.

Munguan: Lirije Kajtazi, Petar Miletic dhe Rasim Demiri

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-ja Lejla Selimi, përfaqësuesit nga KDI-Besnik Ramadani, përfaqësuesi i KKK-Veton Berisha, përfaqësuesi nga Presidenca-Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtje të dëshmitarëve nr. 04/L-015, me raportin e Komisionit funksionale për Legjislacion, me amendamente.
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndihmë juridike falas nr. 04/ L-017, me raportin e Komisionit funksionale për Legjislacion, me amendamente.
5. Miratimi i raportit me rekomandime në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
6. Të ndryshme

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi - konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluar.

Kryesuesi – konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 20.07.2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtje të dëshmitarëve nr. 04/L-015, me raportin e Komisionit funksionale për Legjislacion, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin për mbrojtje të dëshmitarëve nr. 04/L-015, të propozuara nga Komisioni Funksional. Kërkoj nga anëtarët të deklarohen nëse ka ndonjë vërejtje në amendamente në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, që do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Meqë nuk kishte vërejte, kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtje të dëshmitarëve nr. 04/L-015, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndihmë juridike falas nr. 04/ L-017, me raportin e Komisionit funksionale për Legjislacion, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin për ndihmë juridike falas nr. 04/ L-017, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoj që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për ndihmë juridike falas nr. 04/ L-017, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Miratimi i raportit me rekomandime në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,

Kryesuesi, në fjalinë e tij tha se lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, komisioni jonë është informuar se Komisioni për Integritet Evropian ka paraqitur raport me rekomandime se Projektligji është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të legjislacionit të Be-së, bazuar në kriterin e parimit të Kushtetutshmërisë.

Ai shtoi se Projektligji është amendamentuar nga grupi punues, i udhëhequr nga Albert Kinolli andaj fjalën ia dha për sqarime konkrete.

Albert Kinolli – ai mendon se Projektligji fillimisht duhet të procedohet në Seancë Plenare, me që të merret qëndrim përfundimtar lidhur me këtë Projektligj.

Edhe si anëtarë në komisionin për Integritet Evropian ofroi opinionin e tij se Komisioni për Integritet Evropian gjatë shqyrtimit të raportit me amendamente të Komisionit Funksional, ka nxjerr Rekomandim përfundimtar ku është konstatuar se projektligji është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Qëndrimi i këtij komisioni ka qenë përfaqësimi i komunitetit

malazez dhe atij kroat, dhe se të drejtat e tyre ti gëzojnë në bazë të kushtetutshmërisë e cila është në fuqi.

Myfera Sinik- theksoi se e përkrah propozimin e dhënë nga komisioni, që fjala ‘mund të jenë’ të zëvendësohet me fjalën ‘duhet të jenë’.

Ajo tha se në nenin 3, ka vërejtje teknike andaj propozoi të jetë radhitja me tekstin si në vijim: Pjesëtarët e komunitetit jo shumicë në Republikën e Kosovës janë komuniteti serb, **turk, boshnjak**, rom, ashkali, egjiptian, goran, malazez dhe kroat si dhe komunitete të tjera.

Etem Arifaj – në bazë të përmbajtjes së rekomandimit të marrë nga Komisioni për Integritet Evropian lidhur me Projektligjin, ai kërkoi sqarim lidhur me nenin i cili është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ai propozoi që Raporti i komisionit tanë të mos hyjë në rend dite për shqyrtim në Kuvend, deri në marrjen e informatës adekuate se Projektligji është në kundërshtim me kushtetutshmërinë

Lumnije Morina- pajtohet me propozimin e parafolëstit se rekomandimi i komisionit për Integritet Evropian lidhur me Projektligjin me amendamente të propozuara nga komisioni jonë është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Por ka vërejtje se i njëjti Rekomandim nuk është përmbajtjesor sepse nuk përmban arsyetimin e duhur. Lidhu me këtë paqartësi mendon që duhet të harmonizohen ndryshimet Kushtetuese e pastaj komisioni të dalë me Raport përfundimtar.

Agim Kuleta- në fjalinë e tij tha se miratimi i Projektligjit është një hap mbrapa sepse Ligjet duhet të jetë në përputhshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Është i mendimit që të përkrahen propozim ndryshimet që do të bëhen në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, por ekziston dilema se a do të miratohen ato ndryshime në Kuvend.

Pajtohet me Raportin e nxjerr nga Komisionit për Integritet Evropian se Projektligjit është në kundërshtim me Kushtetutshmërinë. Ai konsideron se Projektligji duhet të miratohet në Kuvend pa ndryshime plotësuese.

Kryesuesi - ishte i mendimit që Komisioni për Komunitete dhe Kthim të miratoi raportin me amendamente në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës dhe se i njëjti të shqyrtohet për miratim në Kuvend.

Në bazë të diskutimeve dhe vërejtjeve të shumta, Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim mur qëndrim që mbledhja të shtyhet për ditën e nesërme në orën 10.00 me të njëjtën pikë të rendit të ditës, me qëllim që kjo çështje konkretisht të definohet.

Mbledhja përfundoi në orën 15:50

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic